




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-26935/22 datë:20.09.2022



Npi – 01/295 datë: 27.09.2022

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 27.09.2022, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -IX- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 27.09.2022, (e martë) në ora 9.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: Rrahman Jakupi, Përparim Ramusa, Lumni Amrushi, Besartë Musliu-Spahija, Adem Ramadani, Hasan Avdyli, Hamëz Tërshani, Albana Podvorica, Adelina Beqaj, Besnik Seferi, Gëzim Haxhiu, Reshat Mujota, Asllan Beqaj, Shkurte Mustafa, Sanije Sadiki, (Heroina Selmani on-line), Kadri Emini, Rrezartë Ramadani, Muhamet Ademaj dhe Rexhep Gashi.

Në mbledhje përvèç anëtarëve të Kuverndit kanë marrë pjesë edhe: (Kryetari, z.Qemajl Aliu), Drejtoret: DKA, z.Lulzim Sahiti), (DZHE, z.Kastriot Shabani), (DAP, z.Valon Januzi), (DPUKGJ, z.Grejtalb Emini), (DSHMS, z.Isa Haxhiu), nga (ZKF-ja z.Bujar Ferati dhe znj.Kimete Ukaj), Nga (Zyra për Informim, znj.Anita Kurti), nga (IT z.Shpëtim Gashi), nga (Njësiti për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, z.Reshat Gashi), nga (OJQ "YAHR" z.Bekim Krasniqi), nga (OSBE, z.Mefail Mustafa).

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31.08.2022,
2. Pyetje - Përgjigje,
3. Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve nga ZKF,
4. Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025, (pas diskutimit publik),
5. Propozim – Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/60 për zgjedhjen e KKSB,
6. Informatë nga DSHP përgatitjet dimërore dhe menaxhimin e mbeturinave,
7. Informatë nga Komisioni i KRM "Pastërtia",

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, në parim pajtohem me rendin e ditës. Propozojë që pika 3 e rendit të ditës të kaloj në vendin e 4 të rendit të ditës, pas Planit Buxhetor.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës. Por lista e kërkesave nuk është, dua ta di pse e keni hequr nga rendi i ditës?

z.Kadri Emini; Përshëndetje, e përkrahu propozimin e Përparimit që të ndryshohet rendi i ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje pajtohem me rendin e ditës, mendoj se është e drejtë të ndryshohet pikë e propozuar nga Përparimi.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se me caktuar rendin e ditë ne jemi konsultuar me ZKF-në, kështu që ka qenë kërkese e tyre renditja e tillë e rendit të ditës. Në vazhdim ne ja japim fjalën Bujar Feratit për të dhënë sqarime.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Përshëndetje, raporti është shumë i shkurtë dhe nuk na merr kohë shumë për me përfunduar shpejtë, prandaj edhe e kemi lënë si pikën e tretë. Ndërsa Plani Buxhetor është pikë më voluminoze, ka më shumë diskutime dhe do të na merr kohë më shumë, mirëpo ju mundë të vendosni vetë për radhitjen e pikave

z.Përparim Ramusa; Në këto rrethana nuk ka kushte për me mbajt mbledhjen, sepse po e shohë që kolegia Heroina Selmani, e cila është on-line dhe ne kemi marrë vendim për ta ndryshuar nenin 3.5 të rregullores që ka të bëjë me pjesëmarrjen në mbledhje on-line.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ne jemi konsultuar me MAPL-në dhe ata na kanë thënë se ende nuk e kanë konfirmuar ndryshimin e rregullores.

z.Rahman Jakupi; U ngrit, shkoi te video projektori dhe hoqi kabllon e rrymës ku edhe e shkyçi nga puna video projektorin pa e pyetur askënd.

z.Përparim Ramusa; Fillimi i Kryesues nuk na dhatë sqarim se deri sa të kthehet konfirmimi nga MAPL-ja, vendimi i Kuvendit mbetet në fuqi, prandaj unë po të sugjeroj që me zbatuar vendimin e Kuvendit, sepse ne ta kemi marrë këtë të drejtë për me inkuadruar ndonjë anëtarë të Kuvendit online.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Me vendimin e Kuvendit është ndryshuar vetëm nenin 3.5 i rregullores ndërkaj që në rregullore e kemi edhe nenin 3.6 ku na lejon inkuadrimin e anëtarit të Kuvendit online.

z.Reshat Mujota: Përshëndetje, po shihet që u krijua një situatë që nuk është për lakmi, është një deklaratë e juaja se nuk do të ketë më inkuadrim on-line. Unë po ndie keqardhje për këto vandalizma, prandaj po kërkojë që me qitë në votim rendin e ditës me qëllim që të vazhdojë mbledhja.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Në vazhdim lexoi nenin 3.5 të rregullores i cili është ndryshuar dhe më pastaj e lexoi edhe nenin 3.6, i cili e lejon inkuadrimin on-line të anëtarit të Kuvendit.

z.Rahman Jakupi; U ngrit nga karriga shkoi dhe e mori video-projektorin, fillimi i Kuvendit, më pastaj ai të njëjtin e kapi dhe ja dha znj. Adelina Beqaj e cila e vendosi video-projektorin nën tavolinë.

z.Besnik Seferi; Në bazë të rregullores të punës së Kuvendit anëtarit të Kuvendit i lejohet kyçja online, megjithatë unë nuk po mund të pajtohem me gjestet që i bëri këtu z.Rahman Jakupi, e që e mori pajisjen e IT (Video-Projektorin). Këto gjeste nuk janë të hijshme për PDK-në.

z.znj. Adelina Beqaj; Këto vandalizma që i quani ju, nuk janë të tashme por janë nga ju. Pse ti Kryesues nuk ke propozuar që të ndryshohet edhe nenin 3.6 i rregullores.

z.Hamëz Tershani; Kryetari e përmendi vandalizmin, por kjo nuk është diçka e re këtu, sepse ka ndodhur te ju në nivelin qendororë. Sa i përket nenit 3.5 dhe 3.6 të rregullores ky Kuvend mundet edhe me shkarkuar Kryesuesin, sepse ky nuk ka asgjë më shumë se ne.

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje, vandalizmat që po fillojnë këtu nuk e kanë vendin në Kuvend, sepse pajisjet e Kuvendit nuk guxojnë të preken, sepse janë të Kuvendit. Ne kemi qenë si LB kundër vandalizmave. Këtu nuk janë prekur pajisjet e VV-së por pajisjet e Kuvendit, kështu që askush nuk guxon të vepron në një formë të tillë. Te neni 3.5 i rregullores unë kam votuar "Kundër", ndërsa te neni 3.6 i rregullores nuk është ndërryrë. Apeloj që ti kthehem normaliteti të punës së Kuvendit.

z.Kadri Emini; Në mbledhjen e kaluar të Kuvendit unë nuk kam qenë prezent, por vendimet e Kuvendit i kontrollon MAPL-ja. Tani po e shoh se neni 3.6 i rregullores nuk është ndryshuar, dhe Kryesuesi ka të drejtë me e kyçur Heroinën në mbledhje on-line. Unë nuk e kuptoj pse me u ndryshuar rregullorja, sepse po ma mundëson jo vetëm mua por secilit anëtarë që të inkuadrohet online, kjo për arsyje se çdo ditë e më shumë jeta dhe puna po digjitalizohet.

z.Përparim Ramusa; Replikë, ne e kemi marrë një vendim për me e ndryshuar nenin 3.5 të rregullores. Neve na kanë votuar qytetarët për me ardhur në mbledhje të Kuvendit , e jo për me votuar nga shtëpia ose puna.

z.Rahman Jakupi; Të nderuar qytetarë po me dhimbset koha me sqaruar, por kjo nuk është vandalizëm, të gjithë jemi të barabartë, unë vendosa me hequr aparatin nga rryma me e sjell këtu për me u zbatuar ligji. Hamëza është jurist ndërsa ne të tjerët nuk jemi juristë. Nëse rregullorja e lejon inkudrimin on-line pse po keni frikë, ju mund ta ndryshoni sepse i keni votat. 20 anëtarë jemi prezent, gjysmën e anëtarëve i keni ju me votën e dyfishte të Kryesuesit mund ta ndryshoni.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Në ora 09:53h dha 10 minuta pauzë.

Në ora 10:35h Kryesuesi e vazhdoj mbledhjen e Kuvendit. Në fillim Kryesuesi i bëri thirrje z.Rahman Jakupit që ti kthej pajisjet në vendin e vet, sepse aty e kanë vendin dhe ato janë të Kuvendit.

z.Përparim Ramusa; Unë po e tërheqë propozimin dhe po e bëjë një propozim të ri, që pika e tretë të shtyhet për mbledhjen tjetër të Kuvendit.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare e ZKF; Përshtendetje ne e kemi për obligim ligjorë që Raportin Periodik me e prezantuar në Kuvend dy herë në vit. Ky nuk ka nevojë për me u votuar, ne e kemi afatin ligjor të cilin duhet me respektuar dhe raportin me e dorëzuar.

Kryesuesi, Adnan Ademi; Sa po e shoh unë u pajtua edhe z.Përparim Ramusa.

* **Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31.08.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për këtë pikë.

z.Rahman Jakupi; Procesverbalitë më raport me mbledhjet e kaluara ka një përmirësim të dukshëm dhe është më mirë, e falënderojë atë që e ka punuar. Kam një përmirësim te faqja 14 te diskutimi im, të shënohet edhe diskutimi i drejtorit të Arsimit. Po ashtu të përmirësohet emri i Besart në Besartë.

z.Reshat Mujota; Te pika e 3 faqe 13 te DKA, unë nuk kam thënë se informata është e kompletuar, por kam thënë “është e mundur të jetë e kompletuar”. Për ata kam bërë pyetje. Lagja e Azem-Hajdarve nuk është në Mollopolc por në Petrovë. Dhe tjetra unë atë ditë më mbledhje nuk e kam prezantuar telefonin por fotot në telefon.

* **Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja më 31.08.2022.**

Pika 2

Pyetje - Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për këtë pikë.

znj.Shkurte Mustafa; Pyetje për DPUGJ-në, meqenëse kanë filluar asfaltimi i rrugëve “Topilla” dhe “Taravillazi” kur do të përfundojnë këto rrugë?

znj.Besartë Musliu-Spahija; Pyetja e parë për Kryesuesin e Kuvendit, pse kërkosat e qytetarëve nuk janë sjellë në Kuvend? Pyetja e dytë për DPUGJ-në, punimet a kanë me vazhduar deri nalt te pishat? Pyetje e tretë për DPUGJ-në, a do të bëhet kanalizimi në rrugën “Qorr Ilazi” në Reçak?

znj.Adelina Beqaj; Pyetje për drejtorinë e Inovacionit, pse nuk po vjen drejtoresha? Përveç që nuk po vjen ajo, edhe shumë gra tjera po ikin nga zyra e Kryetarit? Pyetje për DSHP-në, drunjë dekorativ kanë filluar të dëmtohen a do të ndërmerrni diçka për rregullimin e tyre? Pyetje për DSHP-në, a keni bashkëpunim me kompanitë publike të ujit dhe të mbeturinave? Pyetje për DSHMS-në, a do të vazhdoni që ti ndihmoni me pakon, familjet skamnore?

z.Besnik Seferi; Pyetje për DKA-në, cilat kanë qenë hapat konkret që keni ndërmarrë për shkollat që janë në greva?

z.Albana Podvorica; Pyetje për DKA-në, dje kemi mbajtur mbledhjen e KAKRS-së dhe askush nga drejtoria nuk ka marrë pjesë, pse? Pyetje për DKRS-në, kur do të vendosen ulëset te stadiumit?

Pyetje për DSHP-në, te parku i pishave janë dëmtuar disa kabllo të rrymës, nuk e dimë a kanë rrymë apo jo, unë po kërkojë një informatë nga drejtoria për këtë çështje?

z.Muhamed Ademaj; Pyetje për DPUKGJ-në, kur do të fillojë rregullimi i kanalizimit në lagjen "Ademaj"- Petrovë?

z.Adem Ramadani; Pyetje për DSHP-në, te rruga "Ahmet Shtimja" dhe "Skender Salihaj" janë krijuar deponi ilegale të mbeturinave, aty po grumbullohen edhe qenët endacak, pastaj aty është edhe një burim i ujit që shkon te lagja e Azem-Hajdarëve që është rrezik sepse mundë të kontaminohet uji, a do të ndërmerrni diçka për largimin e tyre? Pyetje për DPUKGJ-në, rruga "15 Janari" është asfaltuar pjesërisht, mirëpo në disa vende asfalti ka fjet, pse nuk është bërë menjëherë riparimi i rrugës?

z.Rexhep Gashi; Pyetje për DKA-në, në mbledhjen e Komitetit për Arsim nuk ka marrë pjesë drejtori, unë po kërkojë një sqarim se pse drejtorët nuk po marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit? Pyetje për DKA-në, sa janë bërë përgatitjet dimërorë nëpër Shkolla, dhe a kanë filluar? Pyetje për DSHP-në, parkingu i është marrë Handikosit dhe ata kanë mbetur pa parking, a keni ndërmarrë diçka lidhur me këtë?

z.Hamëz Tërshani; Pyetje për Kryetarin, dhe Drejtoreshën e kulturës për sa i përket futbollit për klubin "Vjosa" pse nuk janë krijuar kushtet për banjot e klubit?

z.Përparim Ramusa; Pyetje për Kryetarin, ke premtuar edhe drejtorin e Bujqësisë pse nuk e ke formuar deri tani? Pyetje për Kryetarin, çfarë dobie u sjellë qytetarëve të Komunës vizita e juaj në Komunën e Podujevës, e jo në Komunat për rrith sështë Komuna e Ferizaj-it etj.?

z.Rahman Jakupi; Pyetje për Kryetarin, ka qenë premtim i juaj për de politizimin e QKMF-së, mirëpo aty keni punësuar vëlla un e drejtorit të Arsimit, si dhe keni punësuar aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje. Pyetja është, çka ka ndodh me de politizimin e Arsimit dhe Administratës?

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, tani mundë të përgjigjem vetëm në dy pyetje, për sa i përket rrugës "15 Janari" kompania (punë kryesi) nuk ka pasur vullnet me e krye punën deri në fund. Ne e kemi lënë të pushojë me qëllim mos me e pre asfaltin. Për sa i përket shenjëzimit duhet me e bërë një projekt të ri. Në vitin 2023 do të bëjmë zgjidhje edhe për "Handikosin".

Pika 3

Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve nga ZKF

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; E kemi obligim ligor që 2 herë në vit me prezantuar Raportin Periodik të ZKF-së në Kuvend. Materialin e keni marrë dhe e keni lexuar. Ky nuk kërkon aprovin e juaj. Kemi me e dorëzuar këtë raport te Zyra Kombëtare e Auditimit. Shumica e të gjeturave do të janë të reportuara, nëse ka ndonjë pyetje urdhëroni.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për shtjellimin, e kemi diskutuar edhe në KPF, 6 të gjeturë janë të zbatuara kurse 9 janë në procese. Ju inkurajoj sepse ju jeni duke u munduar me kryer punën e juaj.

znj.Shkurte Mustafa; Përshëndetje, desha me u lidh me kontratën e shkollës filllore në fshatin Carralevë, e cila është nénshkruar në vitin 2017 në të cilën kanë qenë të paraparë si buxhet për këtë shkollë 511 mijë euro në kontratë ndërsa janë zbatuar 492 mijë euro ku diferenca është 19 mijë euro nuk janë zbatuar ende nga kjo kontratë. Ku është bartur kjo shumë dhe a do të ndërmerr komisioni diçka për këtë shumë.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Ne jemi në kontakt me Ministrinë e Arsimit dhe po kërkojmë sqarime për këtë, kjo është në vazhdën e të gjeturave që janë në procedurë e sipër.

z.Rexhep Gashi; Ky dokument po sillet qe dy herë në Kuvend. Te projekti i rrugës në Jezerc kemi paqartësi dhe projekti ka mbetur në gjysmë.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Na jepni ju lutem vetëm numrin e projektit që ta dimë saktësisht se për cilin projekt është fjala, a është i përfunduar a është ende në proces.

z.Rexhep Gashi; Po bëhet fjalë për projektin e rrugës Devetak-Jezerc i cili nuk është duke u zbatuar, pyetja është a është bërë shkelje?

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Kjo është një pyetje teknike, kështu që për më shumë informata mundet me dhënë drejtoria e Prokurimit.

Pika 4

Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, Zyrta Kryesor Financiar; Faleminderit, materialin për Planin Buxhetor e keni marrë qysh në mbledhjen e kaluar të Kuvendit, besojë që e keni lexuar. Ashtu qysh jeni në dijeni Kuvendi ka marrë vendim që Planin Buxhetor ta nxjerrë në diskutim publik, bazuar në këtë vendim ZKF-ja ka organizuar procesin e diskutimit publik me qytetarët me grupet e interesit dhe subjektet politike. Shuma totale e buxhetit të Komunës së Shtimes për vitin 2023 është 8.756,040 euro. Në vazhdim Bujar Ferati i lexoi shumat e planifikuara sipas ndarjeve buxhetore në kategori ekonomike dhe në grante, (shih dokumentin). E dini të gjithë se buxheti është dokumenti kryesor i komunës së Shtimes mbi të cilin ka edhe diskutime të shumta nga qytetarët. Ne i kemi të gjitha procesverbalet të diskutimeve publike, pjesëmarria nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar mirëpo ka pas edhe diskutime të cilat janë marrë parasysh në hartimin e draftit të planit buxhetor 2023. Unë nuk po e zgjati më shumë ju ftojë që ta miratoni, nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Pëershëndetje për të gjithë, sot para vetit kemi një dokument shumë të rëndësishëm. Jam i lumtur që ta prezantojë sot para jush dhe qytetarëve planin buxhetor për vitin 2023 i cili është më i madh se sa buxheti i vitit të kaluar për mbi 1 milion euro. Kjo e paraqet edhe efektin e grumbullimit si dhe dëshirën dhe besimin e qytetarëve për ti paguar taksat komunale, dhe nga kjo rrjedhimisht edhe ne kemi përfituar projekte nga Qeveria. Ky është një buxhet gjithëpërfshire i cili është bazuar edhe në zotimet tona, por edhe i bazuar në raport me nevojat e qytetarëve dhe mundësit tona financiare. Për sa i përket projekteve të mëdha ne po punojmë ngushtë me qeverinë qendrore, për Shtimen e ngecur mbrapa me vite, kështu që në emër të barazisë me Komunat e tjera po fitojmë edhe ne disa projekte. Po punojmë për dislokimin e Entit Special, për ndërtimin e objektit të ri të Administratës Komunale, për ndërtimin e objektit të QKMF-së si dhe për irregullimin e shtratit të Lumin Shtimjanja. Segmentet që kanë mbetur pa u përfunduar, siç janë rruga Shtime – Lipjan do të fillojë edhe ajo ndërtimin e saj. Ka edhe projekte të tjera në të cilat jemi duke punuar ngushtë me Ministrinë. Unë ju ftojë që bashkërisht ta votoni këtë buxhet me qëllim që ti ofrojmë mundësinë e implementimit të projekteve të planifikuara me këtë buxhet.

z.Reshat Mujota; Faleminderit, unë kam marrë pjesë në të gjitha debatet publike. Te vlera monetare te fshati Mollopolc nuk ka ndryshime. A ka mundësi që me participim me u bë rrafsh 10 mijë euro. Nuk e kam parë në buxhet drejtorin e bujqësisë dhe inovacionit, si qëndron puna e tyre.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Është mirë që fillimi i marrë të gjitha pyetjet e pastaj me dhënë përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Te projektet me bashkëfinancim keni të drejtë me i ndryshuar.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare e ZKF; Propozimet duhet të hedhen në votim, deri sa të aprovoohen dhe pastaj më nuk mund të ndryshojnë.

z.Reshat Mujota; Nëse arrijmë që të gjitha këto projekte me i krye me 30 mijë euro e që unë nuk besoj, për këtë arsyesh unë po propozojë që të merren nga shifra 90 mijë euro e të del te kolona e 8 dhe aty të bëhen 40 mijë euro te fshati Mollopolc. Kërkoi sqarime për te Zona e Biznesit ku janë planifikuar 20 mijë euro, edhe muri edhe rruga unë nuk besojë që mund të realizohen. Pyetje për Kryetarin për sa i përket Drejtorisë së Bujqësisë dhe Inovacionit a do të jenë apo do të shuhën?

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Sa i përket sektorit të pagave buxhetin e kemi të kufizuar. 711 vende të punës na ka lejuar Ministria e Financave. Ne do të shohim bashkë me ju nëse mundemi që ti themelojmë këto drejtori në përputhje me ligjin, kështu që ne do të vijmë para jush me propozimin konkret.

z.Reshat Mujota; Me sa po e shohë unë pozicioni i drejtoreshës për Inovacion do të rregullohet. Te shpronësimet unë nuk po shoh kërkosat për shpronësim, sepse i kemi shtyrë ato. Pyetja ime është se a

do të mbylllet Drejtoria e Inovacionit, sepse kjo ka ekzistuar pastaj është mbyllur dhe ka kaluar te DZHE-ja? Dhe pyetja e dytë e ka Drejtori të Bujqësisë?

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Ne e kemi bërë një kërkesë në MAPL-ë dhe kemi pyetur nëse këto drejtori që janë, a janë legale apo jo, dhe po presim përgjigje. Ne do të vijmë në Kuvend me propozim konkret. E kemi përpala mundësin, mirëpo duhet që të dakordohemi me ligjin dhe kjo mbetet për tu parë.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Te shpronësimet, krejt projektet shkojnë në nivel qendrorë për ti analizuar, kjo do të jetë një sfidë sepse kemi kërkesa të shpronësimeve të pa kryera. Me shpronësime përmomentin kemi të bëjmë vetëm me” Unazën e Vogël” të Qytetit.

znj.Shkurte Mustafa; Unë desha ta përgëzojë ekzekutivin për një planifikim gjithëpërfshirës buxhetor po shihet se ky buxhet është punuar mbi parimin e barazisë dhe gjithë përfshirjes. Para vetit kemi një dokument ku shohim se në komunën e Shtimes janë përfshirë të gjitha fshatrat. Në të gjitha fshatrat shohim se ka investime kapitale. Gjithashtu edhe unë kamë qenë pjesë e debateve me qytetarë ku konkretisht mundem me fol për fshatin Godanc ku kërkesa e tyre ka qenë ndarja e një vije buxhetore për Godancin e Poshtëm dhe Godanc i Epërm, gjë e cila është realizuar me këtë planifikim buxhetor. E njëjtë kërkesë për një vijë të veçantë buxhetore kanë qenë kërkesa edhe për fshatin Rashincë dhe Gllavicë këto kërkesa janë planifikuar. Na gëzon fakti që në këtë buxhet kemi rritje mbi 1 milion në krahasim me vitin e kaluar.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit, Kryetarit dhe ZKF-së që ka rritje. Mirëpo çdo vit ka pasur rritje, në fillim buxheti është filluar me 100 mijë marka. Mendoj se arsyesa e rritjes së buxhetit është rritja e çmimeve. Të përgëzoj përritjen e numrit të punëtorëve në QKMF, por dorën në zemër duhet me bë diçka. Nuk është e vërtet që ka gjithpërfshirje në ndarjen e buxhetit, i ke lënë tri fshatra më të mëdha pa investime: Petrovë, Pjetërshticë e Muzeqinë, i ke lënë me 214 mijë euro. Çka ndodh me projektet qe nuk i ke realizuar, çka ndodh me rrugën Zborc – Pjetërshticë që nuk e keni kryer, unë mendoj që pritet me shkuan ne suficit. Kuvendi i Komunës ka marr vendim përritimin e unazës së qytetit, asnjë cent nuk është ndarë, pastaj ne e votuam përrit me futur ne buxhet rrugën te “Kulla e Lirisë” e ju nuk e keni futur. Ne nuk mundemi kështu ta votojmë këtë buxhet, d.m.th në këtë formë ne nuk mundemi të votojmë. 70 mijë euro i keni ndarë përrit me futura, ndërsa përrit me fshatin Muzeqinë 40 mijë euro.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Kjo është lista e propozuar e projekteve kapitale, dhe nuk ka diskrepanca të mëdha sikurse që ka ndodhur më herët. Qytetarët do ta shohin gjatë realizimit të projekteve. Nuk ka pasur ndonjëherë buxhet më të balancuar se sa ky i viti 2023. Ju e dini që keni pasur buxhet elektoral siç është rasti me sallën e sportit në fshatin Zborc ku janë ndarë 10 mijë euro, pavarësisht kësaj ne do ti shtyjmë projektet përrita. Edhe rruga që u përmend këtu Pjetërshticë - Zborc është në prokurim, mirëpo traseja e kësaj rruge do të vazhdojë: Godanc i Epërm, Godanc i Poshtëm e deri te Hani dhe do të kryhet brenda këtyre tri viteve qeverisje. Rruga te ”Kulla e Lirisë”, është rrugë me dinjitet dhe duhet të bëhet e mirë, mirëpo kostojë e kësaj rruge mund të shkojë edhe deri në 1 milionë, kështu që qytetarët e dinë fort mirë se ne si Komunë me i investuar këtu në këtë projekt 1 milionë, projektet tjera duhet të presin me vite. Është mirë që me qenë serioz në këtë projekt ashtu si edhe e meriton ajo rrugë, në bazë të rrethanave historike që lidhen me atë rrugë, mirëpo kapacitete tona nuk mund ta mbulojnë, prandaj unë po punojë ngushtë me qeverinë qendrore që me u bë edhe kjo rrugë. E di që ne të gjithë kemi dëshirë por mundësi përrita bërë vet nuk kemi.

z.Përparim Ramusa; Replikë, aty nuk jemi duke bërë tunel, prandaj 2.5 km rrugë nuk mund të kushtojnë 1 milionë euro.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Ne e kemi bërë aty një vizitë me ministrin Liburn Aliu dhe me disa ekspertë të fushës të cilët kanë ardhur në përfundim se aty nuk mundet me bë një rrugë e ngushtë, por që duhet të jetë një projekt në përputhje me rendësin që ka. E kemi një zotim nga ministri Aliu dhe unë i besoj, prandaj edhe po kërkojë mirëkuptim nga ju.

z.Përparim Ramusa; Tash po e shohë që je bërë politikan.

z.Lumni Amrushi; Shumë po flasim përrit UQK-në është dikush para jush nga fshati Pjetërshticë që i ka vendos shkronjat e UQK-së, dhe jemi krenar përrit ato, por nga Qeveria Komunale nuk po përfshihet

në buxhet. Rruga e planifikuar në Pjetërshticë ende nuk është përfunduar, meqenëse shkronjat janë të njëjtë së paku të trajtohen njëjtë, ashtu sikurse në Reçak. Disa propozime të vogla që i kemi a duhet me u votua për ZKF-në a jo.

znj. Adelina Beqaj; Të hyrat vetanake janë ngritur në vitin 2021, kështu që kjo është e trashëguar. Ne kemi formuar dy zona ekonomike. Ju keni premtuar edhe dy zona të reja ekonomike. Te kultura ju keni premtuar se keni me rregullua Qendrën Rinore mirëpo unë nuk po shohë një planifikim buxhetor. Marrëveshjet gojore me ministrin mua nuk po më duken të arsyeshme. Rrugët e arave në Petrovë janë të shtruara me zhavorr te lagja “Tërshani” ajo rrugë është e kryer, unë jam kritike për këtë buxhet. Kërkojë që në këtë buxhet të përfshihen të gjitha gratë dhe të lironen nga taksat e biznesit.

z.Besnik Seferi; Replikë me Adelinën kur thotë kjo se ne i kemi votuar dy zonat ekonomike, kjo duhet të thuhet ne si Kuvend i kemi votuar dy zonat ekonomike e jo të thuhet (ne) ku len me nënkuptuar si parti. Ne si Vetëvendosje më herët kemi kërkuar gjithmonë që të bëhet specifikimi i projekteve, gjë që nuk është bërë ndërsa tani siç po shihet i kemi të specifikuara. Po ashtu kemi kërkuar ndërtimin e urës në fshatin Petrovë. Mirë që tani janë cekur vendet e ndërtimit të urave. Për lagjen e Pajtimit fatmirësisht banorëve mundë të ju themi se ka me u ndërtuar. Po ashtu edhe në fshatin Gllavicë ka projekte e që më parë nuk është ditur që i takon Komunës së Shtimes nga qeveria e kaluar. Rruga “Skënderbeu” në Belincë që tani mund ta kemi të asfaltuar. E kam arsyetuar vendimin për planifikimin e buxhetit për veturnat, qiraja mujore për to është tani 695 euro e që i bie në vit 8340 euro. Është një buxhet i planifikuar mirë. Ka pas organizim të mirë dhe janë futur projekte që janë të mirë pritshme për banorët.

znj. Adelina Beqaj; Kadria tha që e keni pasur një buxhet jo të mirë paraprakë. E nga ajo që the ti Besnik po shihet se ne më herët kemi pasur një buxhet të mirë.

z.Besnik Seferi; Replikë Adelinës, unë jamë në Vetëvendosje, por nëse një çështje nuk është në përputhje me interesin e qytetarëve unë nuk jam aty. Sa i përket veturnave unë e shoh këtë çështje kështu, investimet në vetura nuk duhet me vazhduar me qira, sepse është një shumë e madhe nëse llogaritet në shpenzimet vjetore të qirasë dhe sërisht jemi pa vetura, kështu që këto mjete të qirasë është më mirë të shkojnë në projekte të tjera për qytetarët.

z.Përparim Ramusa; Besniku tha e keni harruar Gllavicën, nuk është e vërtet, sepse aty u bë, Rruga, Ujsjellsi, Shkolla, Ndriçimi e do të bëheshin krejt, a je ti në VV a Kryetari, qartësohuni ju në mes veti.

z.Adem Ramadani: Ke dhënë premtim për Shtabin e UÇK-ë e rrugën, pse nuk ka hy Shtabi i UÇK-ë Kryetari, **z.Qemajl Aliu;** Sa i përket Shtabit të UÇK-ë në Rancë unë e kam dhënë sqarimin më herët. Neve nuk na lejohet kod i veçantë për këtë, për arsyen se për këtë çështje kompetente është Agjensioni për Përkujdesjen e Memorialëve, dhe ata e kanë buxhetin e tyre kjo është e para dhe e dyta aty nevoitet që të zgjidhet kontesti që është në Gjykatë, mirëpo ai do të bëhet. Veturnat po përmenden bukur shumë, unë do t'ju jap një sqarim se ne i kemi dy vutura me qira, e të cilat nuk janë të përshtatshme për terrenin e Komunës tonë. Këtu nuk po bëhet fjalë për xhipa luksozë por po themi për vutura të cilat kishin me u përshtatur më mirë në terrenin e Komunës tonë. Ne kemi bërë një kalkulim brenda 4-5 viteve ato veturnat do të mbeten pronë e Komunës së Shtimes. Nuk ka nevojë me bë fushatë por duhet që ta ndërpresim një kontratë e cila përfundimisht na largon nga pagesat e panevojshme. Rruga te Kulla e Lirisë sërisht po them se do të bëhet, edhe pse nuk ka qenë zotim i imi.

z.Kadri Emini; Them se plani buxhetor është dokument i rëndësishëm unë i falënderoj të gjithë stafin për punën dhe organizimin e hartimit të Planit Buxhetor, i cili duhet të jetë para së gjithash në interes të qytetarit. Janë bërë debate publike, kanë qenë të ftuara të gjitha grupet e interesit, kështu që janë futur të gjitha priorititet parësore. Pajtohem se do të ishte mirë që të bëhen muret e lumit Shtimjanja në të dy anët por nuk kemi mundësi buxhetore. Ne duhet të jemi konkret në propozime atë që e propozojmë duhet ta arsyetojmë se ku do të merren mjetet financiare. Unë e përkrahu propozimin e Reshatit që të shtohen edhe 10 mijë euro dhe buxheti të kaloj kështu.

z.Hamëz Tërshani; Kryetari foli për Agjensionin e Memorialeve, ky Agjension ka qenë edhe më herët. Edhe sa i përket veturave edhe ne më herët kemi bërë kalkulim për planin buxhetor. Unë për veti jam zotuar se të gjitha projektet kam me i votuar, mirëpo tani në këtë formë nuk mundem me i përkrah. E kemi një grumbull të projekteve që nuk mundë të kalojnë. Ky planë është vetëm kopje e planit buxhetor 2020-2021. Kemi pasur Pandemi, po pajtohem se ka rritje të buxhetit. Kemi edhe projekte aktuale dhe nuk po funksionojnë edhe në nivelin qendrorë. Kjo e pasqyron paditurin e Kryetarit për me dit me i drejtuar projektet. Nëse e merrni parasysh përvojën e stafit do ta kishit një buxhet më të mirë. Vetëvendosjen po e mundon paduria dhe mos përvoja. Fitorja e VV-së ka qenë aksidentale. DZHE i ka qit 20 mijë euro te zonat e biznesit që janë aprovuar në vitin 2007 e që është punuar vazhdimisht. Largimi i objektit të QKMF-së është përmend dhe po përsëritet dhe nuk është ne buxhet.

z.Besnik Seferi; Është shumë keq të kesh qenë drejtor e tash këshilltarë në Kuvend e tash këtu të përmenden fjalë të tillë të pakontrolluara. Te zona ekonomike që është aprovuar në Kuvend edhe ne e kemi dhënë kontributin tonë, po ashtu edhe në vitin 2019.

z.Muhamed Ademaj; Faleminderit për Kryetarin dhe ZKF-në për planin buxhetor. Kjo shpërndarje e buxhetit është ne përputhej të plotë me interesat e qytetarëve. Kërkesat gjatë debatit publik janë përfshirë në dokumentin e buxhetit, kështu që unë do ta mbështes dhe do ta votojë planin buxhetor.

z.Rahman Jakupi; Sa i përket buxhetit një vendim që e ka marrë Kuvendi nuk po respektohet. KPF-ja është bartëse e procesit buxhetor, sa tubime i ka mbajtur KPF-ja, dhe cilat diskutime. Ti si Kryesues është dashur me qenë i ulur aty sepse je edhe kryesues edhe i KPF-së. Së paku dy javë është dashur me u shpall diskutimi publik. E di që kanë marrë pjesë qytetarët mirëpo u përmenden shumë çështje. Si ka mundësi me qenë buxhet elektoral, kur ti po del në fotografi si Kryetar e po krenohesh. Te formimi i Zonave Ekonomike, unë nuk kam qenë atëherë ndoshta Hasani e din më mirë. Nuk ka nevojë konsultime me Ministrinë por propozimin vetëm e paraqet në Kuvend, dhe ne vendosim. TV Spin ka një kërkesë për transmetimin e mbledhjeve, çka do te ndodhë me te. Kuvendi nuk është bartës i diskutimit publik por KPF-ja, kështu që këto dhe shumë arsyaje të tjera na bëjnë që ne nuk do ta votojmë këtë buxhet.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë kam qenë ne secilin debat publik, aty, ku po thoni ju nuk kam qen i ulur sepse nuk kam qenë mirë me shëndet.

z.Rexhep Gashi; Dihet se ky është dokument i rëndësishëm, pra Buxheti është i përafërt me interesat e qytetarëve. Unë kam propozuar se duhet të vazhdohet e të zgjerohet rruga "Idriz Seferi", kjo u shërbën zhvillimit të bizneseve, nuk është e vërtet se aty nevoitet ndonjë shpronësim siç është thënë. Nuk është përfshirë trotuari te rruga "Besim Sopa", edhe për kundër faktit se këtë rrugë e kemi përmendur edhe vite më parë. Pastaj kemi kërkuar ndërtimin e nënkalimi në fshatrat, Pjetërshticë, Belinc dhe Gjyrkoc. Nuk janë përfshirë edhe vend-ndaljet për Autobus në Pjetërshtic. Dokumenti i Planit Buxhetor është pak më ndryshe se viteve të tjera, sepse po shihet që ka ndodhur specifikimi i projekteve. Unë mendoj se aprovimi i këtij buxheti duhet të jetë akt solemn.

znj.Saniye Sadiku; Po shihet që ne këtu e kemi një opozitë destruktive që nuk po dëshiron për me i qu projektet përpëra për interes të qytetarëve.

z.Reshat Mujota; Rreth këtij Buxheti ka vërejtje, kur po e shoh po me duket sikurse buxheti i Naim Ismajlit. Në vitin 2017 ka kërkuar TV-Spin transmetimin e mbledhjeve. A është e arsyeshme me u nda 10 mijë euro për garazhet, kur e dimë se duhet mjete për mirëmbajtjen e makinave, pastaj 10 mijë euro për arkivin. Sa i përket transparencës unë i them Besnikut që të pranohet edhe TV-Spin.

z.Bujar Ferati, Zyrtari Kryesor Financiar; Gjatë diskutimeve që po bëhen unë nuk po mundem me i specifikuar projektet e propozuara, ashtu siç e përmendi p.sh Kadri Emin. Sa i përket TV-Spinit ai mundet me ardhur me kërkesën konkrete në drejtorin kompetente dhe nëse ka subvencione mund ti ndahen, por sa e di unë nuk ka pasur ndonjë shpallje për të konkurruar për transmetimin mbledhjeve të Kuvendit.

znj.Kimete Ukaj, Zyrtare e ZKF; Tani më të gjithë e dimë se ka një rritje të buxhetit. Te stafi e kemi një rritje të cilën e shpjegoj Kryetari, po ashtu edhe aspektin e shkronjave të UÇK-së e

shpjegojë Kryetari. Ne duhet ti japim mundësin Kryetarit për realizimit e projekteve nëse këto projekte futën në Buxhet me miratimin në Kuvend. Për transmetimin e mbledhjeve të Kuvendit kjo çështje duhet me shkuar përmes procedurës së prokurimit të drejtoria e prokurimit. Unë nuk jam për mos me e marr, por jo në formën një burimore.

z.Besnik Seferi; Unë po nisem nga fundi e po shkojë te fillimi. Për arkivin unë nuk jam ekspert, për sa i përket veturave unë e sqarove më parë, veturat do të shkojnë vetëm aty ku kanë punë. Nuk e kam votuar buxhetin e kaluar pikërisht për arsyje të mos specifikimit të projekteve. Sa i përket kërkesës se TV-Spin unë nuk kam thënë të mos jetë mbledhja e transmetuar, mirëpo nëse e shohim dhe kemi vullnet ne si Kuvend mund ti ndajmë mjetet në buxhet për transmetimin mbledhjeve.

z.Lumni Amrushi; Unë propozojë që ta ndërroni parafolësin me drejtorin e Kaçanikut, sepse ky po i njeh procedurat shumë mirë. Duhet me toleruar pak se krejt ato transmetime i ka marrë nga facebook. U zgjat shumë kjo çështje dhe shyqyr që po votohet ky buxhet, sepse atëherë ju filloni me projekte. Projektet me numër 27 dhe 30 a janë të specifikuara apo jo. Shyqyr që janë dokumentet se kemi mundësi që ti shohim, ato veç pak janë më shumë të specifikuara. A duhet të trajtohen shkronjat e UÇK-së dhe a duhet të trajtohet Shtabi në Pjetërshticë. Me pakë buxhet mundon me u fut disa projekte të vogla. Propozojë që të rrënohet objekti i vjetër i shkollës në Pjetërshticë.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; U thanë shumë gjëra, nëse ka objekte që ngajnjë njëra me tjetrën është çështje e juaja, sepse ky buxhet nuk është kopje e asnjë buxheti tjetër, nëse e ke votuar atëherë ta shohim pra a po e voton edhe tani këtë buxhet. Ndriçimi u bë para tri vitesh dhe i ngjan asaj çështjes së liberalizimit të vizave, mirëpo projektet duhet të vazhdojnë. Kimete Ukaj dha sqarime sa i përket kërkesës së TV-Spin, sepse këto çështje si kërkesa të tilla nuk mund të bëhen kështu, sepse ka procedura te prokurimit që duhet të përfillen.

z.Reshat Mujota; U diskutuan shumë gjëra a jemi këtu ne QKMF a në Kuvend, Këtu nuk jemi të sëmur dhe nuk lejoj askush me më ofenduar. Në bazë të këtij buxheti që unë po e shoh, mua po me duket sikurse buxheti i Naim Ismajlit, kështu thash. Unë të kam mbështetur ty Kryetar duke menduar se vjen nga Tirana si një djalë i ri e shkolluar por jo një rebel. Unë e lëshojë mbledhjen e Kuvendit në ora 13:38h.

z.Kadri Emini; Në emër të Grupit Parlamentar ne nuk kemi më diskutime, tu kisha lut që ti jepni nga 2 minuta për diskutim për përfaqësuesit e grupeve dhe të shkojmë në votim.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Sa i përket pyetjes së z.Amrushit mundë të ju them se ne kemi biseduar me pjesëtaret e shoqatave ku kanë marrë pjesë edhe familjarët e juaj, dhe kemi ra në dakord që do të bëjmë atë sipas mundësive tona duke u bazuar në të hyrat vetanake, sepse nuk mundë të kemi një kod të ndarë buxhetor për këtë çështje.

z.Lumni Amrushi; Unë dua ta kem një përgjigje nga Bujari a u lejohet a po jo me pas kod të veçante buxhetor.

z.Besartë Musliu-Spahija; Në emër të PDK-së, për shkak të këtyre fjalëve të Kryetarit e lëshojmë mbledhjen e Kuvendit në ora 13 e 45h.

Mbledhjen e kane lëshuar këta anëtarë të Kuvendit:

1. z.Rrahman Jakupi – PDK
2. z.Përparim Ramusa – PDK
3. z.Lumni Amrushi – PDK
4. z.Besartë Musliu-Spahija – PDK
5. z.Adem Ramadani – PDK
6. z.Hasan Avdyli – PDK
7. z.Hamëz Tershani – PDK
8. z.Albana Podvorica – PDK
9. z.z.Adelina Beqa – PDK
- 10.z.Reshat Mujota – I PAVARUR

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Me qenë se kuorum kemi ne mund të vazhdojmë me mbledhjen e Kuvendit. Fjalën ja dha Kryetarit.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Unë po dua ti njoftoj qytetarët se siç po shihet subjekti PDK-së si opozitë po duan që ta sabotojnë dokumentin më të rëndësishëm të Komunës siç është buxheti për vitin 2023, po shihet që ata kërkuant vetëm një pretek për ta lëshuar mbledhjen. Këtë e ka pa edhe qytetari, prandaj unë po bëjë ftesë për mirëkuptim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 11 anëtarëve prezent në mbledhje, (një anëtarë i kyqur on-line, znj.Heroina Selmani) që nënkupton se kuromi për vazhdimin e mbledhjes ekziston prej 11 anëtarëve.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2022, e mbajtur më 27.09.2022, unanimisht aprovoi Buxhetin e Komunës së Shtimes për vitin 2023 në shumën totale prej 8,756,040 euro.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pas aprovimit të buxhetit, po jap 1 orë pauzë për drek në ora 14:05h. Me mbledhjen do të fillojmë në ora 15:00h.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pas përfundimit të pauzës filloi mbledhjen në ora 15:32h. Kemi pritur gjatë që opozita të kthehet në sall, mirëpo po presim edhe 5 minuta për me u kthyen opozita në sallën e Kuvendit. Me qenë se nuk u kthyen, kryesuesi mbledhjen e vazhdoi në ora 15:39h.

Pika 5

Propozim – Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/60 për zgjedhjen e KKSB

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për këtë pikë. Lexoi dokumentin e ardhur nga FSK-ja të datës 19.04.2022 që kanë kërkuant me zëvendësuar përfaqësuesin e FSK-së në mbledhjet e KKSB-së z.Milaim Musliu, me përfaqësuesin tjetër z.Gzim Morina, me arsyetimin se z.Milaim Musliu tani është i angazhuar në detyra krejt të tjera dhe nuk mund të jetë pjesë e KKSB-së. Ndryshimi tjetër është që në vendim të shënohet edhe emri i z.Bajram Ilazit si përfaqësues i KPK-së me arsyetimin se tani është i zgjedhur si Kryesues i Komiteti për Komunitete, ndërkaq që në kohën e aprovimit të vendimit ende nuk ka qenë i zgjedhur. Në vazhdim po e hap diskutimin për këtë pikë.

z.Rexhep Gashi; Jam për ta vazduar mbledhjen. Dua të lidhem me atë që the opozita e ka lëshuar mbledhjen, nuk është opozita, sepse siç po shihet unë jam këtu, edhe që jam opozitë, prandaj duhet ta cekësh me emër subjektin që e ka lëshuar mbledhjen. Kërkoj nga ti Kryesues që ta përmirësosh fillimin e mbledhjes sepse fillove me fjalën opozitë duke thënë që nuk janë në sallë opozita, e unë jam opozitë këtu.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Faleminderit Rexhep për përmirësimin, ke të drejt, kërkoj falje, pra po ceku që subjekti politik i PDK-së e ka lëshuar mbledhjen. Sërisht po e konstatoj kuorumin për me kaluar këtë pikë, i cili është prej 11 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më: 27.09.2022, unanimisht miratoi Vendimin për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/60 të datës 28.03.2022 për zgjedhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, me ndryshimet e lexuara nga Kryesuesi i Kuvendit**

Pika 6

Informatë nga DSHP për përgatitjet dimërore dhe menaxhimin e mbeturinave

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Bardhyl Rushiti.

z.Bardhyl Rushiti, Drejtor i DSHP; Kompania për grumbullimin e mbeturinave KRM “Pastërtia”, ka pasur probleme kryesisht për shkak të mungesës së makinerisë. Fatmirësisht tani kemi edhe dy makineri më shumë. Sfidë janë deponit ilegale, mirëpo si arsyë për këtë është kryesisht mungesa e buxhetit, gjithashtu sfidë mbetet definitiv i lokacionit për grumbullimin e mbeturinave inerte. Te mirëmbajtja kemi një kontratë kornizë të trashëguar, me kompaninë “Ardhmëria”. Në vazhdim lexoi pjesët kryesore të informatës (shih dokumentin). Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigj.

z.Rexhep Gashi; Faleminderit drejtor, dua të pyes sepse i kemi 23 deponi ilegale, çfarë masash keni ndërmarr për largimin e këtyre grupeve të mbeturinave? Unë mendoj se ekzekutivi duhet me dal në

teren me pa gjendjen. Ju thatë që tani kemi makineri më shumë, unë nuk po e shoh gjendjen e më të përmirësuar, sepse ka 3 javë që në disa ekonomi familjare te unë nuk janë marrë mbeturinat. Çfarë masa jeni duke ndërmarrë ndaj tyre, sepse po degradohet ambienti.

z.Bardhyl Rushiti, Drejtor i DSHP; Në informatë e thashë këtë, që sfidë janë deponitë ilegale, është një prej sfidave, sa i përket menaxhimit të mbeturinave, e sa i përket mirëmbajtjes së makinerisë kompetencat i ka menaxhimenti i kompanisë. Makineria shtesë ka ardhur në muajin Mars, dhe mund të them se është zbutur pak situata me grumbullimin e mbeturinave. Sa i përket furrave të gëlqeres, në Karaqicë ato i kemi rrënuar për momentin nuk ka, por mund të ndodhë që po aktivizohen këto furra gjatë të dielave, po e shfrytëzojnë rastin e vikendeve.

z.Rexhep Gashi; Vetëm para Komune 20 metra jo më larg e pashë një deponi, besojë diku një rimorkio mbushet me mbeturina. Inspektorët duhet vetëm të marrin masa e mandej këto masa duhet ti udhëhiqni ju si drejtori.

z.Bardhyl Rushiti, Drejtor i DSHP; Nuk është kjo deponi, është hera e shtatë diku që i kemi hequr, si sot janë hequr në mëngjes i kemi gjete sërisht aty. Mendojë që duhet të identifikojmë familjet që jetojnë në atë bllok, e që ende nuk e kemi një identifikim të atyre që banojnë aty.

z.Muhamed Ademaj; E falënderoj drejtorin për informatën, është një irregullore komunale e cila e thotë shumë qartë, përgjegjës është kompania e pastrimit KRM “Pastërtia”. Duke i ditur detyrat e saj si ndërmarrje publike unë mendoj se nuk po reagojnë si duhet, kërkojë ta ndryshojmë këtë irregullore të hapet mundësia për të konkurruar edhe operatorët privat, si dhe të bëhet vendosja e kamerave. Një pyetje e kam se a kemi ndonjë vend të caktuar për groposjen e shtazëve të ngordhura?

z.Bardhyl Rushiti, Drejtor i DSHP; Jemi duke hulumtuar për këtë, së bashku do ta bëjmë edhe këtë zgjidhje sepse e di që është problem, sidomos gjatë therjes së shtazëve gjatë festave.

z.Besnik Seferi; Faleminderit drejtorit për informatën, desha me ditë cilat kanë qenë hapat që keni ndërmarrë për largimin e deponive ilegale sa ka qenë numri i shqiptimit të gjobave për ata që i kanë hedhur këto mbeturina nëse është e mundshme me na dhëne këtë informatë?

z.Bardhyl Rushiti, Drejtor i DSHP; Sa i përket deponive arsyja se pse nuk kemi mundur me bëdiçka, është pikërisht për shkak të mungesës së buxhetit dhe kontratës së mirëmbajtjes për të cilën fola më parë, e cila na ka ngarkuar me pagesa nga buxheti i dedikuar për këtë drejtori, pra e kemi problem të bëjmë kontratë të re. Te puna e gjobave nuk po kemi alternativë për mbeturinat inerte, do të thotë që nuk kemi ende lokacion por kjo nuk nënkupton që nuk po shqiptojmë apo do të shqiptojmë gjoba në të ardhmen.

Pika 7

Informatë nga Komisioni i KRM “Pastërtia”

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën po ja jap Besnik Seferit pasi që është edhe Kryesues i këtij Komisioni, si dhe ju ka dhënë besimi nga anëtarët e tjerë te Komisionit që të prezantojë këtë informatë.

z.Besnik Seferi; Sot para jush kam me dhënë një informatë për të cilën informatë kam kërkuar edhe nga dy anëtarët e tjerë të Komisionit që ata dikush ta jap këtë informatë, por këtë përgjegjësi ma deleguan mua. Dua të ju njoftojë paraprakisht se bazuar në nenin 12 dhe 17 pika f të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03-L-040; Neni 5 paragraf 8.2 të ligjit për ndërmarrje publike Nr. 03/L387 duke e marrë parasysh edhe udhëzimin e Kryetarit të Komunës së Shtimes i cili e obligon ligji për Vetëqeverisje Lokale, duke përfshirë edhe rekomandimet e KPF-së u formua ky Komision i Aksionarëve për KRM “Pastërtia” njësia në Shtime. Ky Komision u formua prej 3 anëtarëve, një anëtarë është propozuar nga Ekzekutivi e ky është z.Bedri Zeqiri, ndërsa anëtarë i dytë i Komisionit është z.Bajram Hajrizi i propozuar nga Kuvendi i Komunë si dhe unë Besnik Seferi anëtar i Kuvendit. Dua të ju informoj se pas zgjedhjes së këtij Komisioni ne paraprakisht kemi pasur një takim bashkërisht si Komision i cili ka qen i thirrur nga ne si anëtar të këtij Komisioni duke u dakorduar edhe bashkëpunuar edhe me Kryesuesin e këtij Kuvendi kemi bërë qe ta kemi këtë takim. Ku pjesë e këtij takimi kemi pasur dy pika të rendit të ditës: njëra ka qen pika për zgjedhjen e Kryesuesit të këtij

Komisioni, e ku unanimisht jam zgjedhur unë si Kryesues. Më pas ne kemi pas edhe një takim me datën 04.07.2022, kemi qen të ftuar në mbledhjen e përgjithshme të bordit të aksionarëve të KRM "Pastërtia", ku pjesë e këtij takimi kemi qenë nga Komunat ku kjo kompani operon me këto shërbime. Kemi diskutuar për çështjet të cilat janë dhe kanë qenë problematik e kahershme të KRM "Pastërtia" në nivelet Komunale. Aty kemi diskutua po ashtu për raportin e auditorit, e më pas kemi diskutuar edhe për çështjen raportit të punës të cilin e ka bërë menaxhmenti i Kompanisë në Ferizaj. Është diskutuar gjere e gjate sa i përket pagesave, janë dhënë shifra të ndryshme, ku i jemi ndalur më gjatë aty, pasi që pagesat e shërbimit na jepin mundësin me pas edhe shërbime më të mira ndaj qytetarëve nga kjo Kompani. Sa i përket pagesave të obligimeve nga qytetarët në muajin shkurt për Komunën e Shtimes ka qenë 20.256 euro në muajin mars ka qen 22.245 euro, në muajin prill 22.281 euro, maj po ashtu ka qen 22.281 euro kurse në muajin qershor ka qen 22.811 ku në total për këtë periudhë ka qenë 132.940 euro. Sa i përket këtij takimi gjithsesi kemi ngritur çështjet dhe shqetësimet tona, ti cilat kanë qenë në sferën e përgjithshme ku jam ballafaquar vet si këshilltar i këtij Kuvendi për 4 vite. Po ashtu kemi diskutuar për çështjen se sa janë të sfiduar punëtorët e kësaj Kompanie në Komunën tonë, si dhe për problematikat të cilat lidhen për drejtorin e shërbimeve publike, ku paraprakisht u dha një informatë nga drejtori i kësaj drejtorie. Pas këtij takimi dhe diskutimeve që kemi pasur me datën 08.09.2022 e kemi paraparë që ta kemi një plan pune. Mund t'ju them se ka qen plani i par i veprimit në Kosovë që ne e kemi marr si iniciativë që ta bëjmë. Ky plan do të na ndihmoj besoj që të jemi sa ma aktiv, e nuk është arsyja që t'ju përzihemi në kompetenca që s'na takojnë neve. Temat që i kemi diskutuar kanë qenë: Hartimi i planit të grumbullimit te mbeturinave, metoda dhe gjetja e një mundësie për eliminimin e mbeturinave në lumin Shtimjanja, pajisjet e punëtorëve, pagat që me të vërtet pagat janë një shqetësim shumë i madh. Si konkluzion ka buruar nga kjo mbledhje që ta kemi një plan pune, për të pasur mundësi që te trajtojmë çdo çështje, që më pas të mund ti rekomandojmë edhe drejtorit të DSHP-së por edhe organeve tjera kompetente sikur këtij Kuvendi që jemi edhe vet këtu. Ne si Komisioni është hera e parë ndoshta që po japim një informatë të tillë, në të ardhmen do ta keni edhe të shënuar këtë informatë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Faleminderit Besnik për informatën, kjo informatë lidhet edhe me Informatën e DSHP-së, për këtë arsy edhe kemi kërkuar që ti kemi dy informatat në të njëjtën mbledhje të Kuvendit. Prandaj konsideroj se është diçka e mirë që sot i kemi dhënë sqarimet edhe për mbeturinat edhe për sa i përket punës së Kompanisë "Pastërtia" por edhe për problemet që i kanë.

z.Regjep Gashi; Faleminderit për informatën edhe pse mendoj që kishte me qen mirë që Informatën me na ofruar në formë elektronike.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoj në ora 16:13h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi

Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

